



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr 227/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej një panelisti individual z. Agon Ramadani- Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “ARGO KOMTEL” SH.P.K -Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me makina për kositje te barit” me numër të prokurimit: VU644-22-4817-1-3-6, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues “Komuna e Vushtrrisë”, më datën: 17. 08. 2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet** pajtimi i palëve për ankesën 227/22 të datës 24. 06. 2022 për aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me makina për kositje te barit” me numër të prokurimit: VU644-22-4817-1-3-6, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues “Komuna e Vushtrrisë”.

- II. **Obligohet** AK- KK Vushtrri që aktivitetin e prokurimit “Furnizim me makina për kositje te barit” me numër të prokurimit: VU644-22-4817-1-3-6, konform raportit të ekspertit shqyrtues me të cilin AK është pajtuar ta kthejë në **Rivlerësim**.

- III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.
- V. Me qenë se është aprovuar pajtimi i palëve, OE ankues bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.
- VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues “ARGO KOMTEL” SH.P.K -Prishtinë” si palë e pakënaqur kundër vendimit të AK-së për dhënie të kontratës si dhe kundër vendimit të AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim të datës 17. 06. 2022, ka parashtruar ankesë me numër 227/22 më datën: 24. 06. 2022, për aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me makina për kositje te barit” me numër të prokurimit:VU644-22-4817-1-3-6, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues “Komuna e Vushtrrisë”.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 28. 06. 2022, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 04. 07. 2022, në raportin e ekspertizës ka

deklaruar:

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues / KK-Vushtrisë, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës është furnizime. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Operatori ekonomik ankues me date 15.06.2022 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë autoriteti kontraktues, ndërsa autoriteti kontraktues përmes përgjigjeve se kërkesës për rishqyrtim të datës 17.06.2022 ka refuzuar kërkesën për rishqyrtimi si të pabazuar.

Përgjigje ne Pretendimi ankimor 1

Pretendimi ankimore ka të beje me: Ne kemi ofertuar në këtë aktivitet prokurimi duke i përmbushur të gjitha kërkesat sipas njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, ndërsa AK-ja ka rekomanduar për kontratë OE i cili nuk i ka përmbushur të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, sepse i njëjti në ofertën e tij ka prezantuar dokumentin “Deklaratë e Specifikave Teknike” pa vulë dhe nënshkrim dhe e njëjta është në formatin word:

Eksperti shqyrtues vlerëson se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij ka ofruar deklaratë mbi specifikat teknike mirëpo të njëjtën nuk e ka të nënshkruar dhe as të vulosur, andaj autoriteti kontraktues gjatë procesit të vlerësimit, krahasimit të tenderëve nuk është bërë konform dispozitave ligjore pasi operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka dërguar dokument jo valid pa nënshkrim dhe vulë. Prandaj, pretendimi ankimor i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

me referenca si vërtetim mbi evidentimin e këtyre furnizimeve dhe ky dokument mund të ishte faturë, fletëdërgesë apo pagesë e realizuar ashtu siç është përcaktuar në dosje të tenderit.

Eksperti shqyrtues vlerëson se kërkesa e njoftimit për kontratë dhe dosje të tenderit është kërkuar:

III.4 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Kapaciteti teknik dhe professional

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

OE duhet të ketë përmbushur furnizimet të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit në nga dt. e publikimit të njoftimit për kontratë minimum me vlerë 1500.00 euro. Në rast të grupit OE, lideri i grupit duhet të ketë realizuar së paku 60 % përqindje nga vlera totale e kërkuar. Dëshmia 1 Listën e nënshkruar dhe të vulosur me të cilën specifikohen të gjitha projektet e furnizimeve të ngjashme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës të bashkëngjiten referencat ose raportet e pranimit për kryerje të furnizimeve. (i) kur furnizimet

janë kryer për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e raporteve të pranimit ose referencë ,të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë;

(ii) kur furnizimet janë kryer për një blerës privat, për dëshmi të këtij shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i furnizimeve të tilla;

Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij ka ofruar listën e kontratave të cilat janë të realizuar me blerës privat, si dhe referenca nga blerësit por nuk ka ofruar dëshmi mbi pranimin e mallit apo ndonjë dokument të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimin e tyre, prandaj dokumentin e ofruar nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk janë sipas njoftimit për kontrate dhe dosje të tenderit: Pika III.4 Dëshmia e kërkuar dokumentare: (ii) kur furnizimet janë kryer për një blerës privat, për dëshmi të këtij shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i furnizimeve të tilla, për të cilat OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka ofruara. Prandaj, pretendimi ankimore i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Andaj, autoriteti kontraktues nuk ka vepruar konform Neni 7, Neni 56, Neni 59 dhe Neni 72 të LPP-së gjatë procesit të vlerësimit, krahasimit të tenderëve, mos respektimi i kërkesave në njoftimin për kontratë dhe dosja e tenderit dhe dispozitave ligjore të LPP-së. Neni 56 të LPP-së: Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave 1. Gjatë vlerësimit të tenderëve ose kërkesave për pjesëmarrje të dorëzuara nga operatorët ekonomik gjatë një procedure të prokurimit, autoriteti kontraktues së pari do të përjashtojë të gjithë kandidatët ose tenderuesit të cilët nuk kanë dorëzuar me kohë:

- (i) certifikatat apo vërtetimet të cilat dëshmojnë ose pohojnë se kandidati ose tenderuesi nuk është i ndaluar të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit sipas nenit 65 të këtij ligji, certifikatat, dokumentet ose dëshmitë tjera të mjaftueshme të cilat janë kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga autoriteti kontraktues sipas nenit 66 të këtij ligji me qëllim të vërtetimit të përshtatshmërisë profesionale të kandidatit ose tenderuesit, ose
- (ii) dëshmi të mjaftueshme, siç është përcaktuar në nenin 68 dhe 69 të këtij ligji, të cilat dëshmojnë se kandidati ose tenderuesi i plotëson kërkesat financiare, teknik dhe profesionale të përcaktuara ose të përshkruara në njoftimin e kontratës në pajtim me nenin 51 të këtij ligji

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues është e bazuar, ndërsa të anulohet njoftimi për dhënie të kontratë dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 04 korrik 2022 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti kontraktues me 05 korrik 2022 ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit të OSHP-së, duke deklaruar: *“Konfirmim i pranimit te ekspertizës se ekspertit. Njeherit ju informojmë se pajtohem (ne mënyrë te përsëritshme) me ekspertizën, megjithatë ne do ta pranojmë si tërësi ekspertizën duke e kthyer lenden ne Rivlerësimi, me c’rast, ne procesin e Ri-vlerësimit, do te mirren ne zbatim gjitha dispozita ligjore qe rregullojnë çështjen e vlerësimit te tenderëve ne aktivitetin e prokurimit ne fjalë”*.

Operatori ekonomik me datën 07 korrik 2022 ka njoftuar OSHP se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, deklarimeve të palëve se pajtohen me mendimin e ekspertit shqyrtues për rivlerësim të aktivitetit të prokurimit, paneli shqyrtues deklaroi se procedura e shqyrtimit të ankesës përfundon në këtë fazë, ndërkaq obligohet Autoriteti Kontraktues KK Vushtrri që aktivitetin e prokurimit ta rivlerësoj sipas mendimit të ekspertit shqyrtues profesional dhe brenda afatit 10 ditor konform LPP-së ta njoftoj panelin shqyrtues me veprimet e ndërmarra.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- KK Vushtri

1x1 OE "Agro Komtel"

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.